



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:138405

Datë: 26.09.2024

Numri i dokumentit: 06213497

K.Dh.Shk.II.nr.1747/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija-Ymeri, kryetare e kolegjit, Dren Rugova dhe Ramush Beiqi, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesve të masës së sigurimit 1. NTG “B...”, me NRF: ..., me seli në Prishtinë, rruga “...”, nr.13; 2. N.T.SH. “N...”, me NUI:..., me seli në Prishtinë, rruga “...” dhe 3. N.T.G.I. “G...L...” SH.P.K., me seli në Prishtinë, rruga “...”, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Florim H Shefqeti, kundër kundërshtarit të sigurimit Kompania e Sigurimeve “S...” SH.A., me seli në Magjistralen Prishtinë-Shkup, Lagjja “S...”, Kompleksi ..., duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesve të sigurimit, të parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës–Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Për Çështje Ekonomike, KE.nr.407 /2024, i datës 18.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.25.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e propozuesve të masës së sigurimit 1. NTG “B...”, me NRF: ..., me seli në Prishtinë, rruga “...”, nr.13; 2. N.T.SH. “N...”, me NUI:..., me seli në Prishtinë, rruga “...” dhe 3. N.T.G.I. “G...L...” SH.P.K., me seli në Prishtinë, rruga “...”,ndërsa VËRTETOHET Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës–Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Për Çështje Ekonomike,KE.nr.407 /2024, i datës 18.07.2024.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, në aktvendimin e ankimuar, ka vendosur si në vijim:

“I.REFUZOHET si i pabazuar propozimi i propozuesve të masës së sigurimit 1. NTG “B...”, 2. N.T.SH. “N...”, dhe 3. N.T.G.I. “G...L...” SH.P.K.,” i paraqitur ndaj kundërtashtarit të sigurimit Kompania e Sigurimeve”S...”SH.A, me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e sigurimit ashtu që të i ndalohej Kompanisë së Sigurimeve “S...” SH.A, konfiskimi i garancionit në shumën prej 129,442.00 €, për kompaninë NTG “B...”; konfiskimi i garancionit në shumën prej 46,236.40 €, për kompaninë N.T.G.I. “G...L...” SH.P.K. dhe konfiskimi i garancionit në shumën prej 37,771.00 € për kompaninë N.T.SH. “N...” , në shumën totale prej 213,449.00 €, derisa të vendoset në mënyrë meritore për çështjen kryesore.”

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ankesë ka paraqit propozuesi i masës së sigurimit, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, aplikim të gabuar të së drejtës materiale si dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjës faktike, duke i propozuar Dhomës së Shkallës së Dytë që të aprovojë ankesën si të bazuar të ndryshoet aktvendimin KE.nr. 407 /2024, i datës 18.07.2024, ashtu që të aprovohet si e bazuar kërkesa për caktimin e masës së sigurisë ose të prishet aktvendimi i ankimuar dhe çështjen ta kthej në rigjykim dhe në rivendosje .

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitë kundërshtari i masës së sigurisë edhe pse të njëjtën e ka pranuar me datën 14.08.2024

Kolegji i Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e ankimuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi - Propozuesit e masës së sigurimit 1. NTG “B...”; 2. N.T.SH. “N...” dhe 3. N.T.G.I. “G...L...” SH.P.K., përmes të autorizuarit të tyre, me datën 15.05.2024, pranë gjykatës së shkallës së parë kanë paraqitur propozim për caktimin e masës së sigurisë ndaj kundërtashtarit të sigurimit Kompania e Sigurimeve “S...” SH.A., me të cilën ka

kërkuar që të caktohet masa e sigurisë dhe t'i ndalohej konfiskimi i garancionit për të tri kompanitë në shumën totale prej 213,449.00 €, derisa të vendoset në mënyrë meritore për çështjen kryesore.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas propozimit për caktimin e masës së sigurimit, me aktvendim, e ka refuzuar propozimin e propozuesve për caktimin e masës së sigurisë si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, me arsyetim se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 297 par 1 pika a) dhe b) të LPK-së, për caktimin e masës së sigurimit, sepse masa e sigurimit ka qëllim vetëm sigurimin e kërkesëpadisë dhe ruajtjes së gjendjes ekzistuese, në qoftëse ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vërshtëronte dukshëm realizimin e kërkesës, ndërsa nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesit e sigurimit në këtë fazë të procedurës, nuk kanë ofruar asnjë provë lidhur me besueshmërinë e kërkesës së tyre, me të cilat do të vërtetoheshin pretendimet e tyre lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit, e po ashtu nuk kanë ofruar asnjë provë me të cilën do të mund të provohet se kundërshtari i sigurimit ka ndërmarrë ndonjë veprim drejtë tjetërsimit, fshehjes apo ngarkimit të pasurisë së tij, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndinjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të masës së sigurimit, edhe përkundër faktit që gjykata të njejtëve u ka dhënë mundësinë e paraqitjes së këtyre provave. Krejt në fund ka cek se në rastin konkret nuk plotësohet as kushti se pa caktimin e masës së sigurimit ekziston rreziku që pala kundërshtarë do të mund ta pamundësohet apo vështëronte dukshëm realizimin e kërkesës, pasi që në rastin konkret në shkresat e lëndës nuk gjendet as kërkesa për ekzekutimin e garancionit, andaj si rrjedhojë rezulton se nuk ekziston asnjë rrezik që propozuesit e sigurimit në të ardhmen të mos mund ta realizojnë kërkesën e tyre.

Dhoma e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në

mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë duke shqyrtuar ankesat e propozesit të masës së sigurisë brenda kufijve, gjeti se propozuesi propozuesit NTG “B...”; 2. N.T.SH. “N...” dhe 3. N.T.G.I. “G...L...” SH.P.K ka paraqitë propozim për caktimin e masës së sigurisë në Dhomën e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale duke kërkuar që kundërshtarit të sigurimit ti ndalohet konfeskimi i garancionit në shumë prej 129,442.00euro për kompaninë NTG B..., vlerën e garancionit 46,236.40euro për kompaninë N.T.G.I “G...L...” Sh.p.k dhe vlerën e garancionit 46,236.40 euro për kompaninë N.T.SH N... në total shumë prej 213,449 euro, deri në vendosjen meritore.

Andaj, pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës së cilën veç e veç e edhe lidhshmërinë e tyre Gjykata e Dhomës së Shkallës së Dytë ka vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, që do të thotë e ka vërtetuar aktvendimit të ankimuar, ngase gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë kur ka gjetur se propozimi është i pabazuar, e cila ka mbështetje ligjore si dhe janë dhënë arsyet e justifikueshme të bazuara në shkresat e lëndës, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka marë këtë vlerësim juridik se me nenit 297 pikën 1) nën pikën a) dhe b) të LPK-së parashihet se; *“Masa e sigurimit mund të caktohet; a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështërsonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehejen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”*.

Bazuar në dispozitën e lartëcekur duhet të plotësohen dy kushtet ligjore; propozuesi i masës së sigurimit duhet ta bëjë të besueshme ekzistimin dhe besueshmërinë se pa një masë të tillë kundërpropozuesi do të pamundësonte apo vështërsonte në mënyrë të dukshme realizimin e kërkesës, dhe nëse ekziston rreziku se pa caktimin e masës së propozuar, kundërpropozuesi do ta vështërsonte dukshëm realizimin e kërkespadsisë e sidomos me tjetërsimin e pasurisë me

fshehjen e saj, me ngarkimin apo ndonjë mënyrë tjetër do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese ose në një mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të masës së sigurimit.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dy kushtet e sipërmendura e që në rastin konkret nuk janë plotësuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë fakti se në këtë fazë të procedurës nuk janë ofruar prova dhe rrethanat bindëse lidhur me besushmërinë e kërkesës lidhur me caktimin e masës së sigurisë. Ajo që është më kryesorja nuk plotësohet kushti i dytë ligjor për caktimin e masës së sigurisë ngase, në rastin konkret paditësi ka dështuar të ofroj provë se kundërpropozuesi do të bënte të pamundësonte ose dukshëm do të vështersonte realizimin e kërkespadiës. Kështu, propozuesit e sigurimit në këtë fazë të procedurës, nuk kanë ofruar asnjë provë lidhur me besushmërinë e kërkesës së tyre, me të cilat do të vërtetonin pretendimet e tyre lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit, edhe përkundër faktit që gjykata e shkallës së parë të njejtëve u ka dhënë mundësinë e paraqitjes së këtyre provave por që propozuesit nuk ju kanë përmbajtur obligimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë për ta siguruar provat e kërkuara gjegjësisht kërkesën e autoritetit përkatësisht përfituesit të garancionit e as garancionin e ekzekutimit në mënyrë që edhe gjykata ta ketë më të kurtë lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë. Andaj kolegji i kësaj gjykate vlerësoj se më të drejtë ka vendos gjykata e shkallës së parë kur e ka refuzuar propozimin për caktimin e masës së sigurisë.

Kolegji e dhomës së shkallës së dytë i vlerësoj edhe pretendimet e tjera ankimore të propozuesëve të sigurimit por gjeti se të njejtat nuk përbëjnë arsye që kanë mbështetje ligjore, e për të cilat duhet prishur aktvendimi i gjykatës së parë.

Kështu, nga arsyet e cekura Dhoma e Shkallës së Dytë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 194, 209 paragrafi 1 pika (c) e lidhur 201 pika (b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.Dh.Shk.II.nr. 1747/24, me datë 25.09.2024

Numri i lëndës: 2024:138405
Datë: 26.09.2024
Numri i dokumentit: 06213497

Kryetarja e kolegjit
Franciska Zhitja Ymeri